



Shpëtonxënësin

(që të mos gjëndet i papërgatitur)

MIRESERDHE NE SHKOLLEN TONE!

PER SA VJET DO TU DUHET TE VINI NE SHKOLLE ?

Arsimi i detyrueshëm zgjat 10 vjet:

- 5 vjet të shkollës fillore
- 3 vjet të shkollës tetëvjeçare
- shkolla dyvjeçare

Shkolla fillore zgjat nga 6 deri në 11 vjeç

Shkolla nëntëvjeçare zgjat nga 11 deri në 14 vjeç

Shkolla dyvjeçare zgjat nga 14 deri në 16 vjeç

Shkolla e mesme zgjat nga 16 deri në 19 vjeç


PASI TE MBARONI KETE PERIUDHE SHKOLLORE MUND TE FILLONI UNIVERSITETIN.



ORARI JUAJ I MESIMIT NE SHKOLLEN TONE ESHTË KY NE VIJIM:

nëse frekuenton shkollën Filllore

1. me kohë të kufizuar: nga 8,30 dei në 13,30 nga e hëna deri të premten
2. me kohëtë plotë: nga 8,30 dei në 16,30 nga e hëna deri të premten me drekë në shkollë



ÇFARË TE OFRON SHKOLLA JONE?

LENDET QE DO TE STUDJOSH JANE:

Gjuha italiane

Gjuha e huaj (nga klasa e parë e shkolles filllore: anglisht; në shkollën nëntëvjeçare mund të shtojnë frëngjishten)

Matematikë

Shkencë e teknologji (edukim shkencor e informatikë)

Histori

Shtetësi e kushtetuta

Gjeografi

Studime shoqërore

Vizatim (art e imazh)

Gjymnastikë (shkenca e levizjes e edukim fizik)

Muzikë

Besim feje (nëse prindërit tuaj e kanë bërë këtë zgjedhje)

POR NUK MBARON KETU.....



Zakonisht shkolla organizon kurse të italishtes për nxënësit e huaj që mund ti frekuentosh në orarin shkollor edhe të shtunën në mëngjes, kur nuk ka mësim. Shpesh në shkolle janë Mediatori Culturali(Ndërmjetësues Kulturor) që mund të të ndihmojnë për të kuptuar më mirë gjuhën italiane e gjithashtu për të studiuar lëndët mësimore.

Shkolla ju ofron gjithashtu një sërë *projektesh* jashtë- shkollore në të cilat mund të marrësh pjesë nëse dëshiron.

Mund të përdorësh kompjuterin dhe LIM(tabelën multimediale interaktive)për të studjuar në mënyre më aktive dhe interesante, për të mësuar gjuhët e huaja(anglisht në shkollën fillore, anglisht dhe frëngjisht në shkollën nëntëvjeçare) të bësh aktivitete të lëvizjes o edukim kizik në palester.

Përveç studimit në shkollë, do të kesh mundësi të marrësh pjesë me klasën tuaj në turne me udhëzues, eskursione e kampe shkollore të organizuara nga mësuesit tuaj.



DHE PËR TË DITUR SA MIRE JE ME MESIME?

Vlerësimi i performancës tuaj shkollë bëhet nëpërmjet detyrave të kontrollit me shkrim dhe të ngritjeve në mësim. Dy herë në vit plotësohet dëftesa me notat e marra në lëndë të ndryshme mësimore. Ajo ju prezantohet prindërve dhe do të dorëzohet në fund të vitit shkollor.

Do të kesh një bllok shkollor, në të cilin, secila mësuese do të shkruajë notat që do të marrësh. Blloku do të shërbejë edhe për të justifikuar mungesat, nga ana e prindërve tuaj, e për lajmërimet mes shkollës dhe familjes.



**BLLOKUN DO TA
MBASH GJITHMONE
NE ÇANTE!**



SA ZGJAT VITI SHKOLLOR?

Viti shkollor zgjat rreth 9 muaj.

Fillon në muajin shtator dhe mbaron në gjysëm të qershorit.

Janë dy periudha pushimesh :

Dy javë për krishtlindje(zakonisht nga 23 dhjetori deri me 6 janar) ;

Një javë gati për Pashkë(në mars o në prill).

Janë pastaj disa ditë pushimesh të shpërndara gjatë vitit.

Shkolla njofton çdo herë me një lajmërim të shkruar në ditar.

ÇFARE PRESIM NGA JU?



Në shkollën tonë janë të rëndësishme angazhimi dhe gjithashtu sjellja, që vlerësohet. Në fat, egziston një rregullore disiplinë për nxënësit, që duhet ta respektohet. Mund të gjesh shokë të rinj e të gjithë së bashku në klasë, mund të bashkpunoni për të arritur rezultate të shkëlqyera, në lidhje me respektin ndaj gjithë kulturave dhe vlerave njerëzore. Vit të mbare shkollor!



Buon anno scolastico!

Drejtori i Shkollës

La F.S dhe Komisioni i interkulturës